HVAT

# Kushtet paraprake te certifikimit

## (Kerkesat e kompetences)

Personat që dëshirojnë të certifikohen për kryerjen e detyrave sipas grupit të I duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

1. Të kenë mbushur moshën 18vjeç,
2. Të jetë i aftëfizikisht dhe mendërisht për punë, vecanerisht lidhur me te paret, te degjuarit, aftësitë levizëse, etj
3. Të zotërojë mirë gjuhën shqipe me të shkruar dhe të folur
4. Të këtë mbaruar shkollën 8/9 vjecare ( Arsimin e Detyruar )

Personat që dëshirojnë të certifikohen për kryerjen e detyrave sipas grupit të II duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

1. Të jenë jo më pak se 18vjeç,
2. Të ketë jo me pak se nje vit pune në profilin përkatës të përcaktuarnëRregulloren e sigurimit dhe shfrytezimit teknik per impiantet, pajisjet dhe instalimet elektrike
3. Të ketë kryer edukim profesional teknik (elektrik). Në mungese të këtij edukimi, kërkohet të këtë mbaruar shkollën 8/9 vjecar dhe një trajnim të paktën 8 orë në lidhje me ndihmën e parë dhe njohuritë mbi rrezikun që vjen nga rryma elektrike.
4. Të jetë i aftë fizikisht dhe mendërisht për punë, vecanerisht lidhur me te paret, te degjuarit, aftësitë levizëse, etj
5. Të zotërojë mirë gjuhën shqipe me të shkruar dhe të folur

Personat që dëshirojnë të certifikohen për kryerjen e detyrave sipas grupit të III duhet tëplotësojnë kërkesat e mëposhtme:

1. Të jetë jo më pak se 18 vjeç,
2. Të ketë mbaruar
   a. shkollën 8/9 vjeçare dhe kurs kualifikimi të plote në profesion ose shkallen e ulet profesionale për specialitetin dhe të jetëi certifikuar të paktën 6 muaj më parë sipas grupit të II të sigurimit teknik
   b) shkollën e mesme profesionale të specialitetit dhe të ketë jo më pak se 3 muaj eksperiencë pune.
   c) ciklin bachelor për inxhinieri elektrike dhe të ketë jo më pak se 1 muaj eksperiencë pune.
   d) Ciklin bachelor për inxhinieri jo elektrike dhe të ketë jo më pak se 3 vite eksperiencë pune
3. Të jetë i aftë fizikisht dhe mendërisht për punë, veçanërisht lidhur me te paret, te degjuarit, aftësitë levizëse, etj
4. Të zotërojë mirë gjuhën shqipe me të shkruar dhe të folur

Personat që dëshirojnë të certifikohen për kryerjen e detyrave sipas grupit të IV duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

1. Të jenë jo më pak se 20 vjeç,
2. Të ketë të paktën
   a) 2 vjet certifikimin për Grupin i III$^{te}$ të sigurimit teknik, ose
   b) 1vit certifikimin për Grupin e III$^{te}$ ato persona që kane mbaruar shkolle specialiteti, ose
   c) Mbi 3 muaj eksperiencë pune ne impiantet dhe linjat elektrike ata që kanë mbaruar sistemin bachelor ose master për inxhinieri elektrike.
3. Të jetë i aftë fizikisht dhe mendërisht për punë, veçanërisht lidhur me të paret, tëdëgjuarit, aftësitë levizëse, etj
4. Të zotërojë mirë gjuhën shqipe me të shkruar dhe të folur

Personat që dëshirojnë të certifikohen për kryerjen e detyrave sipas grupit tëV duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

1. Të jetëjo më pak se 24 vjeç,
2. Për kategorinë
   a) e mjeshtrave duhet të ketë mbi 10 vjet në instalimet, impiantet, pajisjet elektrike dhe mbi 3 vjet në grupin e IV$^{-te}$të sigurimit teknik.
   b) teknikëve të kenë të paktën 3 vjet pune në grupin e IV$^{-te}$ të sigurimit teknik.
   c) inxhinierëve elektrik duhet të ketë të paktën 1 vit eksperiencë pune në impiantet ose linjat elektrike.
3. Të jetë i aftë fizikisht dhe mendërisht për punë, vecanerisht lidhur me te paret, te degjuarit, aftësitë levizëse, etj
4. Të zotërojë mirë gjuhën shqipe me të shkruar dhe të folur